



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DREJTORIA E SPITALIT PSIKIATRIK

L. "10 Korriku" Rr. "Pelivan Leskaj" Vlorë Tel/Fax: +355(0)33 205-105 E-mail; s_psikiatrik_vl@yahoo.it

Nr. 89/5 Prot.

Vlorë më 01/03/2016

LËNDA : Një ndryshim në dokumentat standarte të tenderit me objekt "Shërbimin e Rojeve Private"

DREJTUAR : Të gjithë operatorëve ekonomik të interesuar

Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë njofton të gjithë operatorët ekonomik të interesuar se, në zbatim të pikës 2 dhe 2/1 të nenit 42 të Ligjit Nr. 9643 dt. 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, V.K.M Nr.914 dt.29.11.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" neni 62, në dokumentet e tenderit me objekt "**Shërbimin e Rojeve Private**" me fond limit **7.975.692** Lekë pa T.V.Sh dhe me datë të hapjes së ofertave dt. 03.03.2016 ora 10:00 bëhen ndryshimet si më poshtë:

afati i fundit për pranimin e ofertave në sistemin elektronik bëhet:

Data 08.03.2016, ora 10:00

Në shtojcën 7 KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT bëhen këto ndryshime:

1- Kapaciteti teknik pika 4, behet

Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve/Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore se shoqeria ofertuese per vitin 2014, 2015 ka patur nje numer mesatar prej 22 personash te siguruar, ku te jene te percaktuar numri i te siguruarve per cdo muaj sipas ligjit. Keto vertetime duhet te jene te shoqeruar edhe me listepagesat sipas deklarimit ne sistemin e Deges se Tatimeve dhe FDP. Ne keto listepagesa duhet te jene te perfshire emrat e punonjesve te cilet te perputhen me emrat qe ndodhen te konfirmuara ne vertetimin e drejtorise se policise vendore. Sigurimet duhet te jene paguar sipas ligjit 75/2014 dhe udhezimit 157 date 01/04/2015. Ne listpagese duhet te jene te pasqyruar edhe shtesat e turnit te dyte dhe te trete sipas nenit 81 te "Kodit te Punes".

2- Kapaciteti teknik pika 6, behet

1. Vertetim te leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Vlore per vitin 2016 qe te permbaje:
 - Te dhenat per subjektin

- Te dhenat per burimet njerezore, mjetet
- Te dhenat per kontrollet e ushtruara gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit
- Problematikat e konstatuara gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit
- Mendimin e DPQ ne lidhje me vleresimin e performances dhe te ligjshmerise te aktivitetit te subjektit
- Te kete nje numer prej 22 rojesh te miratuar.
- Te kete nje automjet ne gjendje te gatshme
- Te kete Qender monitorimi ne qytetin e Vlores
- Te kete shlyer detyrimet prane DPQ per vitin 2014, 2015 dhe 2016
- Te percaktoje pergjegjesin e sherbimit

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KUJTIM LLAPI

